

VENDIM
Nr.55, datë 29.5.2008

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBANIAN
GREEN ENERGY” SHPK**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13 pikat 1, germa “a”, dhe 8 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 10 të “Rregullores për procedurat e licencimit”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007, dhe nenit 18 pika 3 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr.44, datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.5.2008, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Albanian Green Energy”, për t’u licencuar në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike, si dhe prodhimin e energjisë elektrike, (Bllok motorë-gjeneratorë të ushqyer me biomasë të lëngshme, Shëngjin, Lezhë),

dhe konstatoi:

paraqitjen, konform përcaktimeve të rregullores së procedurave të licencimit, të dokumentacionit dhe deklaratave të kërkuara nga ERE kur dokumentacioni mungon,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Albanian Green Energy” sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit, instalimit dhe shfrytëzimit të centraleve elektrike, si dhe prodhimin e energjisë elektrike. (Bllok motorë-gjeneratorë të ushqyer me biomasë të lëngshme, Shëngjin, Lezhë).

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta